



Perspektiva juaj  
është sfida jonë!

Fondi më i ri në fushën e investimeve

## Raport Muaji Gusht 2021

### Informacion bazë

Administrimi i Fondit	<b>Shoqëria Raiffeisen Invest sh.a</b>
Monedha	<b>LEK</b>
Datë Lancimi	<b>20 Gusht 2018</b>
Datë e mbarimit te Ofertes Fillestare	<b>03 Shtator 2018</b>
Vlera fillestare e kuotës	<b>1,000</b>
Shuma fillestare minimale	<b>30,000</b>
Shuma minimale pasuese	<b>10,000</b>
Komision në hyrje	<b>0%</b>
Komision në dalje	<b>2% (cdo shlyerje para 2 viteve)</b>
Komision Administrimi në vit	<b>1.25%</b>
Kosto për transfertë fondesh nga palë të treta	<b>Referojuni informacionit ne deget e RBAL</b>

### Objektivi i investimit dhe profili i investitorit

Objektivi i Fondit është të maksimizoje kthimin total afatmesëm, duke synuar të ruajë kapitalin e investitorit dhe të sigurojë likuiditet të mjaftueshëm.


Fondi synon të ketë një portofol investimesh të përqëndruar kryesisht në instrumente borxhi të emtuara ose garantuara nga Qeveria e Republikës së Shqipërisë.

Për të maksimizuar kthimin total nga investimi, Fondi synon investime afatgjata dhe për këtë arsye, fondi investon të paktën 50 – 80% të aseteve ne obligacione afatgjatë te Qeverisë shqiptare.

### Profili i Rrezikut dhe Përfitimit

Rrezik i ulët  
Përfitimet tipike më të ulëta

Rrezik i lartë  
Përfitimet tipike më të larta



Profili i parashikuar i Rrezikut dhe Përfitimit të fondit Raiffeisen Vizion i përket kategorisë së tretë.

Ky nivel i treguesit është rezultat i aplikimit të politikës së investimit të fondit me të dhënat historike të normave të interesit për 5 vitet e fundit.


Treguesi i rrezikut dhe përfitimit korrespondon me një numër të plotë i cili përdoret për të renditur fondin në një nivel rreziku nga 1 në 7, sipas nivelit të rritjes të luhatshmërisë. Kategoria më e ulët nuk do të thotë që investimi në fond është pa rrezik. Ky tregues ka për qëllim tju informoje mbi luhatshmërinë e çmimit të kuotës së fondit bazuar në historikun e performancës së fondit. Të dhënat historike të përdorura për llogaritjen e treguesit nuk mund të përbëjnë një siguri të plotë për profilin e rrezikut në të ardhmen.

## Të dhëna për Fondin në 31.08.2021

<b>Vlera Neto e Aseteve</b>	<b>16,088,219,500</b>
<b>Numri i investitoreve</b>	<b>5,677</b>
<b>Çmimi i Kuotes</b>	<b>1,115.1048</b>
<b>*Kthimi nga investimi (31.08.2020 - 31.08.2021)</b>	<b>3.58%</b>

\*Komisioni i administrimit zbritet përpara llogaritjes së kthimit nga investimi

## Struktura e portofolit të investimeve në 31 Gusht 2021



Ne kuader të politikës së investimit të fondit Vizion, investimet kryhen kryesisht në obligacione thesari, të emetuara ose garantuara nga Qeveria shqiptare, përmes pjesëmarrjes në ankandet e tregut primar dhe transaksioneve në tregun sekondar.

Politika e investimit parashikon që të paktën 50 – 80 % e asetëve të fondit të investohen në obligacione afatgjate të Qeverisë së Republikës së Shqipërisë. Bonot e thesarit 12 mujore emetohen dy here në muaj; Obligacionet 2 vjeçare një here në muaj; 7 dhe 10 vjeçare janë me të rralla, afërsisht një here në tre muaj. Qeveria organizon ankande të obligacioneve referencë 5 dhe 3-vjeçare me frekuencë një here në 2 muaj për secilin maturitet.

<b>Instrumenti</b>	<b>Ne % të Aseteve të Fondit</b>
Bono Thesari	3.22%
Obligacione Thesari	80.01%
Depozita / Llogari rrjedhese/ Te arketueshme	13.79%
Marreveshje të Anasjellta të Riblerjes – Rev Repo	2.98%

Vlera neto e asetëve të fondit është në nivelin e LEK 16.1 miliardë në datë 31 Gusht 2021.

## Zhvillimet dhe ecuria e normave te interesit te titujve te Qeverise Shqiptare gjate muajit Gusht

Pavarsisht përhapjes se variantit Delta ne te gjithe boten, situata në BE dhe Britani te madhe duket premtuese. Për herë të parë në BE përqindja e njerëzve të vaksinuar plotësisht e tejkalon SHBA-n, gjithashtu me një numër te larte të njerëzve të vaksinuar me një doze dhe qe jane gati për të marrë dozën përfundimtare. Situata në SHBA mbetet e pasigurt dhe infektimet e reja vazhdojne të rriten. Ne Shqiperi gjithashtu numri i te infektuarëve vazhdon te rritet ndjeshem per shkak te variantit Delta. Nga ana tjetër, procesi i vaksinimit po kryhet me ritme te shpejta ne Shqiperi ashtu si ne shume vende te botes.


Asetet e Fondit Vizion jane te investuara vetem ne bono dhe obligacione te emetuara nga Qeveria e Republikës se Shqiperise dhe per kete arsye fondi eshte i ekspozuar ndaj ndryshimeve ne normat e interesit te ketyre titujve. Keshtu investimet e fondit nuk kane lidhje direkte me tregjet nderkombetare, por impaktohen kryesisht nga zhvillimet ne tregun e brendshem sic jane ndryshimet ne normat e interesit te titujve te Qeverise Shqiptare.

Pergjate muajit Gusht ne tregun vendas normat e interesit te titujve te emetuar nga Qeveria Shqiptare ndoqen nje trend rrites, me perjashtim te Bonos se Thesarit 3-mujore.

Yield-i i Bonos se Thesarit 12-mujore rezultoi ne 1.768% me nje rritje prej 26 pikesh ne krahasim me ankandin e muajit Korrik. Yield-i i Bonos 6-mujore rezultoi ne 1.336% duke u rritur me 12 pike ndersa yield-i i Bonos 3 mujore rezultoi ne 0.865% duke rene me 13 pike ne krahasim me ankandin e fundit.

Ankandi i rihapur i obligacionit 2 vjeçar-i i emetuar ne LEK rezultoi ne 2.20%, i pandryshuar ne krahasim me normen e ankandit paraardhes. Per sa i perket obligacioneve afatgjate, u zhvillua obligacioni reference 3-vjeçar i cili rezultoi ne 2.62%, duke u rritur me 18 pike krahasuar me ankandin e fundit te organizuar ne Qershor.

Grafiku me poshte jep nje pasqyre te ecurise se normave te interesit te bonove dhe obligacioneve te thesarit te emetuar nga Qeveria Shqiptare gjate periudhes 1-vjeçare Gusht 2020 – Gusht 2021. Per obligacionet reference 3 dhe 5 vjeçare jane paraqitur yields fikse per llogaritura nga kuotimet e kontributoreve ne fund te muajit Gusht.




## Performanca e fondit dhe ecuria e çmimit të kuotës deri ne 31 Gusht 2021

Fondi Vizion ka patur nje performace te mire mujore dhe çmimi i kuotes eshte rritur me **+0.13%** gjate muajit Gusht.

**Ndersa kthimi me baze vjetore, per periudhen 31 Gusht 2020 – 31 Gusht 2021 eshte 3.58%.**

Duhet patur parasysh se norma e kthimit ndryshon ne varesi te kushteve te tregut, sic jane ndryshimet e normave te interesit te titujve te borxhit te emetuar nga Qeveria Shqiptare. Keshtu kur normat e interesit ne treg rriten, vlere e titujve te portofolit ulet dhe per rrjedhoje ulet dhe norma e kthimit per periudhen e kaluar. E kunderta ndodh kur normat e interesit ulen.

Per pasoje, çmimi i kuotes mund te jete i luhatshem. Luhatsmeria eshte pjese e natyrshme e fondeve te investimit dhe eliminimi i saj eshte i pamundur, keshtu çmimi i kuotes mund edhe te bjere, jo vetem te rritet.



**Fondi Vizion aplikon nje periudhe minimale qendrimi ne fond prej 2 vitesh. Cdo shlyerje perpara permbushjes se periudhes 2-vjet, do te jetë subjekt i nje tarife dalese prej 2% e vleres se kuotave te shlyera.**

Pertej minimumit kohor te qendrimin ne fond, Investitorët e fondit Vizion dhe te gjithë fondeve te administruara nga Raiffeisen Invest keshillohen te kene nje horizont sa me te gjate investimi per te perfituar nje kthim optimal nga investimi dhe ne kete menyre ne periudhe afatmesme apo afatgjate te kene mundesi te rikuperojne edhe efektet negative te krijuara afatshkurter.

Per fondin Vizion ky horizont i rekomanduar i qendrimin ne fond eshte te pakten 3 vjet, duke patur parasysh natyrën afatgjatë të investimeve të parashikuara në strategjinë e investimit të fondit dhe ne menyre qe te permbushet objektivi i performancës së fondit. Investitorët inkurajohen qe te ruajne investimin e tyre duke mos ndryshuar objektivin e qendrimin ne fond te nxitur nga situata jo e zakonshme e krijuar nga pandemia globale, sepse ne kete menyre nuk do te rrezikojne te dalin nga fondi ne momentin e gabuar per investimin e tyre.

Të dhënat per kthimin nga investimi në të shkuarën janë vetëm ilustrative dhe nuk përfaqësojnë nje premtim apo garanci per kthimin ne te ardhmen. Te gjithë shembujt e tjere numerike, jane perdorur per qellime ilustrative dhe analize te te dhenave historike, dhe nuk duhen perdorur nga investitorët per te nxjerre konkluzione per te ardhmen. Investitorët e mundshëm duhet të lexojnë Prospektin dhe Rregullat e Fondit. Raiffeisen Invest dhe forca shitëse e fondit nuk garantojnë nje kthim te caktuar te fondit. Informacioni mbi cmimin e përditësuar të kuotës, prospektin dhe rregullat e Fondit gjendet pranë zyrave të Raiffeisen Invest sha., në web site [www.raiffeisen-invest.al](http://www.raiffeisen-invest.al) ose në degët e Raiffeisen Bank në Shqipëri.